



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 826/1 prot.

Tiranë, më 4.11.2024

**VENDIM**  
**Nr.65, datë 4.11.2024**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT TË**  
**KOMISIONERIT NR. 3, DATË 14.1.2022**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Zbatimin e Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 3, datë 14.1.2022, të Komisionerit, “Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Elbasan, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”.

**KONSTATOVA SE:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Bashkisë Elbasan, i cili pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 1831/1 prot., datë 02.06.2021, ka raportuar në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik. Në këtë institucion punonjësit që plotësojnë këtë kusht, të evidentuar sipas pozicionit të punës dhe momentit të plotësimit të moshës për të përfutur pensionin e plotë të pleqërisë janë: \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*.

Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësit e përmendur më lart.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 3, datë 14.1.2022, të Komisionerit, “*Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Elbasan, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë*”.

Konstatohet se, në datë 29.10.2024, njësia përgjegjëse e institucionit ka dërguar pranë Komisionerit në rrugë elektronike dokumentacionin që materializon veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 3, datë 14.1.2022, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, materializuar në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin objekt i këtij verifikimi, paraqitet si më poshtë vijon:

Për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, ***në pikën 1***, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar përfundimin e marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësit si vijon:

- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Përgjegjës, Sektori Transportit në Drejtorinë e Shërbimit të Territorit Urban*”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Specialist, Sektori Vlerësimit në Drejtorinë e Tatimeve, Taksave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave*”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjet*”.

Vërej se, në lidhje sa më sipër, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan ka nxjerrë aktet e lirimit nga shërbimi civil për këta punonjës, më konkretisht si vijon:

- me urdhrin nr. 848, datë 1.10.2024, “*Lirim nga detyra*”, është liruar punonjësi \*\*\*\*\*;
- me urdhrin nr. 1293, datë 30.12.2021, “*Lirim nga detyra*” njësia përgjegjëse ka liruar nga detyra \*\*\*\*\* në detyrën “*Specialiste*”;
- me urdhrin nr. 1130, datë 11.4.2023, njësia përgjegjëse ka liruar nga detyra punonjësin \*\*\*\*\* nga pozicioni “*Drejtor*”.

Për sa u përket më sipër, vlerësoj se nga ana e institucionit objekt i mbikëqyrjes në vazhdim, Bashkia Elbasan, janë zbatuar detyrat e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi*

*procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *(e ndryshuar)*,

**VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 3, datë 14.1.2022, të Komisionerit, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Elbasan, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Elbasan duke zbatuar detyrat e lëna në dispozitivin e Vendimit nr. 3, datë 14.1.2022.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Elbasan.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**